



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tiranë, më dt. 14 Qershor 2017

## DISA GJETJE DHE KONKLUZIONE PARAPRAKE

### NGA MONITORIMI I PROCESIT PARAZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET E DATËS 25 QERSHOR 2017

1. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), që nga viti 1996 dhe në vazhdim ka monitoruar të gjitha proceset zgjedhore, si ato parlamentare dhe vendore. Për monitorimin e zgjedhjeve parlamentare të datës 25 Qershor 2017 janë akredituar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) 177 vëzhgues të KShH-së, të cilët do të trajnohen dhe pajisen me manualet dhe dokumentacionin e nevojshëm për monitorimin e procesit të votimit dhe të numërimit të votave në 9 qarqe të vendit, përkatësisht në Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Elbasan, Korçë, Gjirokastër, Vlorë dhe Fier.

2. Me Dekretin nr. 9883, dt. 05.12.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë u caktua data 18 Qershor 2017 për zhvillimin e Zgjedhjeve për Kuvendin. Nga muaji Shkurt 2017, partitë opozitare bojkotuan Kuvendin dhe procesin zgjedhor. Pas negociatave të vazhdueshme, veçanërisht me këmbënguljen e partnerëve ndërkombëtarë, BE dhe ShBA, në dt. 18 Maj 2017 u arrit Marrëveshja mes PS dhe partive opozitare të përfaqësuara nga PD, çka ndërpreu bojkotin dhe mundësoi pjesëmarrjen e opozitës në zgjedhje por edhe për plotësimin e Komsioneve përkatëse në zbatim të ligjit për *vetingun*. Sipas Marrëveshjes, Presidenti i Republikës dekretoi datën 25 Qershor 2017, për Zgjedhjet për Kuvendin.<sup>1</sup>

3. KShH, edhe pse e ndërgjegjshme për situatën emergjente që u krijua, gjë që bënte të nevojshme arritjen e një marrëveshje të tillë midis maxhorancës dhe opozitës, vlerëson se disa çështje të natyrës ligjore duhet të sanksionoheshin me ligj, sidomos në përcaktimin e afateve të tjera në Kodin Zgjedhor. Në këtë vështrim, dhënia përparësi e marrëveshjes partiake nuk pajtohet me parimin e shtetit të së drejtës dhe në mënyrë të veçantë me parimin e ligjshmërisë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ndryshimet që u bënë në ligjin mbi partitë politike dhe median, që u miratuan me shumicë votash, ndërsa Kodi Zgjedhor është miratuar votim të cilësuar ku rregullohet edhe çështja e transmetimit të reklamave dhe financimi i partive politike. KShH vlerëson se, moskonsultimi me grupet e interesit i këtyre ndryshimeve ligjore që u hartuan e miratuan në një hark të ngushtë kohor, pa një proces gjithëpërfshirës, çoi në miratimin e disa dispozitave, një pjesë e të cilave bien ndesh me parimet dhe standartet e sanksionuara në akte normative me hierarki më të lartë juridike.

4. Sipas nenit 52, të Kodit Zgjedhor, deri në dt. 6 Mars 2017, kryetari i Njësisë Vendore duhej të merrte masa që, çdo zgjedhës të njoftohej me shkrim në banesën e tij se, në cilën qendër votimi do të votojë dhe në cilin numër rendor të listës së zgjedhësve është emri i tij. KShH ka konstatuar se, njoftimi me shkrim i zgjedhësve të përfshirë në ekstraktet e përbërësve zgjedhorë nuk është realizuar në brenda afatit ligjor dt. 5 Mars 2017, si dhe për të gjithë votuesit. Shtetasit e pyetur në bashkitë e ndryshme<sup>2</sup>, në shumicën e tyre kanë deklaruar që nuk kanë marrë asnjë njoftim me shkrim nga njësitë vendore ku ata banojnë. Nga ana tjetër, punonjësit e zyrave të gjendjes civile apo të bashkive kanë pohuar se ky detyrim ligjor është respektuar qoftë edhe përtej këtij afati ligjor. KShH ka njoftuar Ministrinë e Punëve të Brendshme<sup>3</sup>, pasi vetëm më dt. 1 Mars 2017, ky institucion

<sup>1</sup> Me Dekretin nr. 10351, dt. 21.05.2017, "Për një ndryshim në Dekretin nr. 9883, dt. 15.12.2016 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin".

<sup>2</sup> Informacioni është marrë nga KShH në bashkitë Kukës, Shkodër, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastër dhe Korçë

<sup>3</sup> Me Shkresën nr. 135, dt. 3 Mars 2017, "Mbi njoftimin me shkrim të zgjedhësve në banesë sipas Kodit Zgjedhor"



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ka bërë me dije se ka akorduar fondin prej 13.8 milionë lekë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore për këtë proces.

5. KShH ka monitoruar publikimin e ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë që, sipas ligjit duhet të shpallëshin periodikisht çdo muaj, duke filluar nga dt. 5 Janar 2017. Nga verifikimi ynë në bashkitë e ndryshme rezultoi se, ekstraktet e përbërësve zgjedhorë përgjithësisht nuk janë publikuar në afatin e caktuar pasi ato mbanin datën e një apo dy muajve më parë ose datën e publikimit të parë të tyre (dt. 31.12.2016). U konstatua se ekstraktet herë publikohen pranë zyrave të gjëndjes civile dhe herë në ambiente publike duke mos orientuar qartë zgjedhësit se ku duhet të verifikojnë emrin e tyre në listë, situatë kjo e shkaktuar edhe për shkak të rregullimit ligjor të kësaj çështje.<sup>4</sup> Në disa raste, konstatuam se, ekstraktet zgjedhore janë afishuar në shkolla, kopshte, etj., të cilat mund të aksesoheshin vetëm gjatë orarit ditor të punës apo ishin afishuar në vende që mund të dëmtoheshin nga faktorë të jashtëm. Gjatë kësaj kohe janë raportuar ndryshime të adresës së vendbanimit të shtetasve, ndryshime të cilat janë reflektuar më tej në regjistrin e gjëndjes civile si dhe në ekstraktet zgjedhore. Megjithatë, interesimi i votuesve për t'u njohur me listën e zgjedhësve ka qënë i paktë dhe nga të dhënat që ne disponojmë nuk rezultoi të ketë patur ankesa administrative për korigjimin e tyre. Në bashkitë e verifikuara nga KShH, nuk ka patur asnjë kërkesë për ndryshim të listave zgjedhore përmes gjykatës.

6. Nga vëzhgimi që KShH realizoi në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin në dt. 05.06.2017, rezultoi se, 66 të burgosur në listën e zgjedhësve të këtij burgu nuk dispononin kartë identiteti për ushtrimin e të drejtës së tyre të votës. Nga monitorimi i kryer në këtë institucion rezultoi gjithashtu një shkelje flagrante e dispozitave të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar, pasi nuk ishin përfshirë në listën e zgjedhësve 23 të paraburgosur të këtij institucioni. Sipas këtij ligji, përjashtohen nga e drejta e votës vetëm të dënuarit me vendim të formës së prerë për një nga veprat penale të parashikuara në nenin 2, pika 1, gërmat "a" dhe "b", të tij. KShH i ka adresuar këto shkelje me anë të shkresave zyrtare drejtuar KQZ-së<sup>5</sup>, DPB-së<sup>6</sup> si dhe publikimit të Deklaratës për Shtyp të dt. 09.06.2017<sup>7</sup>.

7. Partitë politike, përveç atyre opozitare kanë respektuar detyrimin ligjor për të paraqitur kërkesë për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ<sup>8</sup> brenda afatit ligjor dt. 8 Prill 2017.<sup>9</sup> Nuk ka rezultuar që subjektet zgjedhore të jenë regjistruar si koalicion zgjedhor në afatin ligjor, dt. 18 Prill 2017. Partitë opozitare janë regjistruar nën siglën e PD, si subjekt zgjedhor pas Marrëveshjes së mësipërme, në dt. 30 maj 2017. Në këto zgjedhje parlamentare nuk merr pjesë asnjë kandidat për deputet që të jetë propozuar nga një grup zgjedhësish.

8. Referuar Kodit Zgjedhor<sup>10</sup>, partitë politike depozitojnë listën shumëemërore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve. Megjithëse nuk është raportuar se këto lista kanë patur nevojë për korigjime, vendimi për miratimin e tyre nga KQZ është marrë brenda afatit të parashikuar në nenin 73, pika 2, të KZ. Pozicionimi i anëtarëve të KQZ-së për çështje të rëndësishme, duke evidentuar qëndrime dhe mendime të ndryshme të cilat përkonin përkatësisht tek anëtarët e propozuar nga shumica parlamentare dhe tek anëtarët e propozuar nga opozita parlamentare, sikurse ishte debati për

<sup>4</sup> Pika 4, e nenit 51, të KZ

<sup>5</sup> Shkresa nr. 257, dt. 09.06.2017, e KShH

<sup>6</sup> Shkresa nr. 259, dt. 09.06.2017, e KShH

<sup>7</sup> <https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/posts/1175952175861644>

<sup>8</sup> Regjistruar nga KQZ në dt. 15.03.2017, 20.03.2017 dhe 03.04.2017

<sup>9</sup> U regjistruan 15 subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend 2017, me një total prej 2180 kandidatë për deputetë nga të cilët 41.70 % femra

<sup>10</sup> Neni 67, Pika 1, i KZ



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

për afatin e regjistrimit të listave të kandidatëve, evidentoi sërish nevojën për depolitizimin e këtij institucioni të rëndësishëm qendror të administrimit zgjedhor.

**9.** Afati ligjor që partitë politike të propozojnë kandidaturat përkatëse për anëtar të KZAZ-ve nuk është respektuar nga të gjitha partitë. Për rrjedhojë, edhe afati ligjor për ngritjen e KZAZ-ve nuk është respektuar pasi vendimi për miratimin e ngritjes së tyre nga KQZ është marrë disa ditë më vonë, në dt. 03.04.2017. Sipas KQZ-së, shkak për këtë tejkalim afati është mospërmbushja e detyrimit ligjor nga dy subjekte politike të partive opozitare për paraqitjen e propozimeve për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve. Në dt. 07.06.2017, KQZ ka zhvilluar trajnimin e parë të Komisionerëve të KZAZ-së pas plotësimit të përbërjes së tyre nga anëtarë të propozuar nga dy partitë opozitare. Në tërësi, plotësimi me vonesë i anëtarëve të KZAZ-së dhe ndryshimi i tyre në mënyrë të vazhdueshme edhe pas marrëveshjes ndër-partiake ka shkaktuar vonesa ose mangësi në trajnimin e anëtarëve, si dhe ka ndikuar në drejtim të uljes së cilësisë së administrimit të procesit parazgjedhor në nivel vendor.

**10.** Pavarësisht se disa subjekte zgjedhore kanë filluar më parë aktivitetet politike se afati ligjor (18 Maj 2017, referuar datës së zgjedhjeve 18 qershor 2017), fushata zgjedhore po zhvillohet e qetë. Subjektet zgjedhore kanë respektuar kriteret ligjore<sup>11</sup> për afishimin e materialeve propagandistike. Vihet re se shpenzimet për fushatën në krahasim me zgjedhjet e mëparshme janë më të ulëta. KQZ ka miratuar me unanimitet Vendimin nr. 167, dt. 21.04.2017 “Për miratimin e udhëzuesit dhe formatit të standartizuar të raportimit financiar të fushatës zgjedhore”, me qëllim rritjen e rolit aktiv të KQZ-së në kontrollin mbi financimin e fushatës zgjedhore dhe rritjen e transparencës në lidhje me fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore.

**11.** Bordi i Monitorimit të Medias (BMM) u ngrit me 12 ditë vonesë nga afati ligjor<sup>12</sup>, megjithë rekomandimin e mëparshëm të OSBE/ODIHR për emërimin e tyre në kohë.<sup>13</sup> BMM ka raportuar çdo ditë mbi mbulimin e fushatës zgjedhore nga operatorët radio-televizivë, për të cilët në ndonjë rast ka sugjeruar dhe është marrë vendim nga KQZ për kompensimin e kohës së transmetimit, për disa subjekte zgjedhore. Megjithatë, Kodi Zgjedhor duhet të përmbajë shprehimisht kriteret e integritetit moral dhe profesional të përzgjedhjes së anëtarëve të BMM-së, të cilat aktualisht përcaktohen me akt nënligjor të KQZ-së. Këto kriteret duhet të forcohen më tej, me qëllim që të garantojnë zgjedhjen e gazetarëve të paanshëm dhe profesionistë në radhët e BMM-së.

**12.** KShH vlerëson se, për verifikimin e integritetit të kandidatëve për deputet në përputhje në përputhje me Ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, KQZ-ja disponon afate të pamjaftueshme për të verifikuar në mënyrë cilësore formularët e paraqitur. Problem mbetet edhe përfundimi i verifikimit të mëtejshëm të dokumentacionit nga KQZ pas kthimit të formularëve nga Prokuroria e Përgjithshme. KShH sugjeron që, kjo çështje të mbahet parasysh në të ardhmen, me qëllim që gjatë zbatimit të ligjit të mësipërm të shmangët çdo lloj formalizmi.

**13. Së fundmi, KShH dëshiron të falenderojë organizatën suedeze, Civil Rights Defenders për mbështetjen financiare të veprimtarisë së kryer për monitorimin e aspekteve të ndryshme të procesit parazgjedhor për Zgjedhjet Parlamentare të datës 25 Qershor 2017.**

<sup>11</sup> Udhëzimi nr. 1, dt. 31.05.2017, “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”

<sup>12</sup> Neni 85, Pika 1, e KZ

<sup>13</sup> Sipas Raportit Përfundimtar për Zgjedhjet Parlamentare të dt. 23 Qershor 2013, të OSBE/ODIHR